



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.127/ 2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga Muhamet Rexha, kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve (KQZ), në lidhje me mostransparencën gjatë shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve të parakohshme 2010-2011 për Asamblenë Parlamentare të Kosovës, në seancën e mbajtur më 02.02.2011, mori:

#### VENDIM

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV)

#### ARSYETIMI

Më datë 31.01.2011 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LVV në të cilën theksohet se “rezultatet e publikuara nga KQZ-ja me datën 30.01.2011 për zgjedhjet e përgjithshme të datës 12.12.2010 nuk përmbajnë rezultatet e subjekteve politike dhe të kandidatëve sipas vendotimeve si dhe nuk sqarojnë metodologjinë se si është arritur deri tek rezultatet. Poashtu nuk është sqaruar ndarja e vendeve në Kuvendin e Kosovës për subjektet politike dhe kandidatët, e sidomos për subjektet politike nga rradhët e pakicave”. Parashtruesi i ankesës konsideron se me rastin e tillë KQZ-ja ka shkelur parimin e transparencës, neni 40 dhe 41 të Kushtetutës, neni 19 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut si dhe nuk e ka zbatuar në tërësi nenin 106 paragrafi 4 pika (i) të LZP-së. Parashtruesi i ankesës thekson se “duke marrë për bazë numrin e madh të shkeljeve dhe manipulimeve gjatë këtij procesi zgjedhor publikimi i të dhënave sa më të plota dhe i mënyrës së përlllogaritjes së rezultateve duhet të jetë minimumi që ky institucion me kredibilitet në humbje do të duhej ta bënte”. Prandaj parashtruesi i ankesës i propozon PZAP-it që ta detyroj KQZ-në që të publikoj të gjitha rezultatet e zgjedhjeve, përfshirë rezultatet nga vendotimet për secilin subjekt politik, për secilin kandidat si dhe të sqaroj për opinionin publik metodologjinë e përlllogaritjes së vendeve në parlamentin e Kosovës, përfshirë edhe rezultatet për subjektet e pakicave.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon:

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.*

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi të gjitha shkresat e lendes gjeti se:

**-ankesa është e pabazuar**

PZAP-i konstaton se ankesa është e pabazuar për faktin se nuk i përmban elementet e detyrueshme të parashikuara në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, dhe për më shumë pretendimet e ankuesit se KQZ nuk i ka publikuar rezultatet e zgjedhjeve përfshirë rezultatet nga vendvotimet për secilin subjekt politik, për secilin kandidat nuk qëndrojnë pasi që të gjitha të dhënat edhe ato për të cilat pretendon ankuesi gjinden në Web faqen e KQZ-së, ndersa rreth metodologjisë dhe përlllogaritjes së rezultateve për subjektet politike dhe kandidatëve, përfshi edhe rezultatet për subjektet e pakicave e gjithë kjo është paraparë me nenin 111 të LZP-së. Prandaj për keto arsye si dhe në kuptim të nenit 115.1 të LPZ-se, PZAP mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitja**

A nr. 127/2010 më datën 02.02.2011.

**Kryesuesi i Panelit**  
**Muhamet Rexha**

